

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Abuzim që të lë pa mend," Braçe: Euro bie, por çmimet mbeten të larta. A nuk duhen taksuar më shumë mbifitimet?
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/-qe-te-le-pa-mend-brace-euro-bie-por-cmimet-mbeten-t-e-larta-a-nuk-i588676
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 08:48:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 09:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c306f4c2f24482fa35a44478025bb58806052e968a13b0d8a1cb2ba2ed6d0253
TEKSTI	c4fdcd266f84a05573e53040c59477c75726e6077ede4bde31afcf4694371ba7
PAMJA	b04418e7ddccf4b3fe9289e9c14c11053512dee8a3cddf3b4a6364d039b24d84

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c8d09267d44ba337b0016b8129738fa3b81a8754f2c0530b82d2d5c4a0a04bcb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b15fa4fb9899cfd04d55deb4808016b106f413d91b2f45c6fda6eeee1406fd0e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/c8d09267d44ba337b0016b8129738fa3b81a8754f2c0530b82d2d5c4a0a04bcb

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by



English



le [Operacioni "Dosja 23" ne Zubin Potok, arrestohen nente te dyshuar per krime lufte urgjoni me 90 kilograme kanabis ndalohej ne Kakavije, droga do te transportohej ne fundit](#)

"Abuzim që të lë pa mend," Braçe: Euro bie, por çmimet mbeten të larta. A nuk duhen taksuar më shumë mbifitimet?



27 Shtator 2026, 11:10Politika TEMA



Pas kryerjes së pazarit të javës, këtë të dielë deputeti socialist Erion Braçe kishte në fokusin e kritikës së tij në rrjete sociale, çmimet e produkteve dhe kursi i këmbimit me të cilin disa supermarkete llogarisin euron dhe dollarin.

Sipas tij, çmimet e perimeve, frutave dhe produkteve ushqimore vijnë të jenë të larta, duke nxjerrë në pah jo vetëm abuzimin e një niveli 'që të lë pa mend' por edhe mungesën e mbështetjes dhe një industri ushqimore që ai e cilëson 'thujasë inekzistence'.

E sa i përket abuzimeve me kursin e këmbimit, Braçe thotë se supermarketet, dyqanet dhe stacionet e karburanteve nuk janë të legjitimuara të këmbajnë monedha të huaja dhe se kanë detyrimin të tregtojnë në lekë.

"Ajo që të lë pa mend është fakti që ndërkohë që leku forcohet, euro e dollari bie, në këto dyqane edhe më shumë se tregu, çmimet e produkteve të importit jo vetëm janë të larta, por janë të qëndrueshme të larta", shkruan ai duke ngritur pikëpyetje nëse me këto parregullësi dhe mbifitime operatorët e tregut duhen taksuar më shumë.

Postimi i plotë i Erion Braçes

E diel sot. Sapo bëra pazarin e javës. Unë dal vetë të blej në tregje e dyqane.

Për çmimet, fjalët kanë mbaruar. Perimet dhe frutat e freskëta, vendase e të importuara, si edhe produktet e përpunuara, thuajse të gjitha të importuara, janë të shtrenjta dhe vijnë të mbeten të tilla. Siç ju dëshmoj në video, këto çmime pasqyrojnë kostot e larta të prodhimit vendas, mungesën e mbështetjes dhe të bashkëfinancimit, si edhe një industri ushqimore thuajse inekzistente.

Por pasqyrojnë edhe një abuzim që të lë pa mend. E them realisht.

Shihni në video njoftimin e afishuar në një, dy, tre supermarkete për kursin me të cilin pranojnë euron dhe dollarin: 90 lekë për 1 euro dhe 77 lekë për 1 dollar.

Së pari, supermarketet, dyqanet dhe pikat e karburantit nuk janë të autorizuar të këmbajnë monedha të huaja. Ato kanë detyrimin të tregtojnë në lekë.

Por ka edhe më. Kursi që afishojnë është shumë më i ulët se kursi zyrtar i Bankës së Shqipërisë dhe ai i tregut të lirë: 91,56 lekë për 1 euro dhe 80,22 lekë për 1 dollar.

Ajo që të lë pa mend është se, ndërsa leku forcohet dhe euro e dollari bien — në këto dyqane edhe më shumë sesa në treg — çmimet e produkteve të importuara mbeten të larta.

Pra, tregtarët i marrin eurot më lirë, madje më lirë se kursi i Bankës së Shqipërisë dhe i tregut. Me këto euro blejnë produkte jashtë, i sjellin këtu dhe na i shesin me çmime që nuk pasqyrojnë rënien e euros apo të dollarit.

Pyetja që kam sot është: A nuk duhen taksuar më shumë këto mbifitime?!

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Situata në vend dhe vizita në SHBA, Rama mesazh sot shqiptarëve nga aeroporti “Nënë Tereza”

09:00 Politika / 16 komente

Rama kthehet nga SHBA, nesër mesazh për shqiptarët nga aeroporti “Nënë Tereza”

22:05 Politika / 34 komente

[Rama me diasporën në New York: Shqipëria nuk ka më nevojë për ndihma! Sazani dhe Zverneci, projekte të jashtëzakonshme](#)

21:53 Politika / 22 komente

"Kërkime të reja dhe mallkimi i kërkimit" Dërguesi i kërkimit me shprehje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.